

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“JODA – Construction” shpk**

Sot, më 08/05/2024, Ortaku Themelues :

Aldo Metaj ,atësia Vezir, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të kartes se identitetit me nr 033513261 dhe numër personal identifikimi I11224094C i datëlindjes 24/12/1981, lindur në Vlore dhe banues në Vlore; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Vendos themelimin e shoqërie tregtare me pergjegjesi te kufizuar “JODA – Construction” shpk sipas termave të mëposhtme:

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Shoqëria “ Joda – Construction “ shpk formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit Nr 9901 dt 14/04/2008 “ Per Tregtaret dhe shoqërite tregtare”, i ndryshuar dhe do te veproje ne baze te ketij akt themelimi dhe statutit te miratuar te saj
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Investime ne fushen e pasurive te paluajtshme dhe ndertimit, restaurimit objekte civile, industriale. Shitjen, blerjen, dhenien marrjen me qira te pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme. Ndertimi dhe rikonstruksionet e ndryshme te objekteve ushtarake, tregtare, turistike, shendetesore, kulturore, sportive, vepra kullimi e vaditje, infrastrukture, sherbime komunale dhe urbane, sherbime pastrimi te siperfaqeve urbane, ndertime rrugore e hekurudhore. Prodhimin e te gjitha materialeve te ndertimit per nevojat e shoqerise dhe tregtimin e tyre me shumice e pakice. Import, export, Tregti artikuj te ndryshem industriale, materiale ndertimi, pllaka, hidrosanitare, materiale elektrike, pajisje dhe vegla pune, mjete te ndryshme pune, makineri dhe pajisje, mjete transporti dhe makineri te renda, dhenie me qera, marje dhenie me qera skela, sherbim transporti dhe magazinimi per te trete. Si dhe cdo veprimtari tjeter te lidhura me to, qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar

Neni 3:

Kohëzgjatja

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**



- 1) Selia e shoqerise do te jete ne adresen :
Lagjja” 29 Nentori” , Rruga “ Gjergj Kastrioti” Rajoni nr.4 Godina objekt Nr 4. Vlore
Adresa e shoqerise per qellime te komunikimit elektronik do te jete si vijon:
aldo.metaj111@yahoo.com
Numra kontakti 0682356705
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë do te jete i perbere nga kontributi i ortakut te vetem themelues te saj , ne vleren 700,000 (shtateqind mije) Lekë, i perbere nga 1 (nje) kuote me vlere nominale 700.000 (shtateqind mije) leke

Neni 6
Organet drejtuese dhe vendimmarrese

Organet drejtuese dhe vendimmarrese te shoqerise jane si me poshte vijon:

- 1- Asambleja e Pergjithshme e ortakeve rolin e te ciles do ta luaje Ortaku i vetem persa kohe shoqeria eshte e zoteruar nga nje ortak i vetem, eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise
- 2- Administratori eshte Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerise

Menyra e organizimit dhe e funksionit te tyre eshte e percaktuar ne statutin e shoqerise.

Administratori i pare i shoqërisë emërohet **Z. Vezir Metaj** , atësia Zaçe, shtetas Shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi F01117039E, i datëlindjes 17/09/1950, lindur në Drashovice dhe banues në Vlore, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë akt themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë akt themelimi dhe statutin e miratuar te shoqerise, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet



- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKU THEMELUES
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
““ Joda – Construction” shpk**

Aldo Meta

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)